



Co-funded by
the European Union

Co-funded by the Swedish
International Development
Cooperation Agency



Sweden
Sverige

THIRRJE PËR PROPOZIME

Njoftuar si pjesë e Veprimit:

**“Avancimi i barazisë gjinore përmes procesit të
para-anëtarësimit në BE”**

**financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancuar nga Agjencia
Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar**

Hapur më: 28 qershor 2021

Afati i aplikimit: 30 korrik 2021

Dorëzimi në: grants@reactor.org.mk

Implemented by:

REAC-OR
research in action



**KVINNA
KVINNA**



**PRAVA
ZASVE**


WOMEN'S RIGHTS CENTER
CENTAR ZA ŽENSKA PRAVA

Përmbajtja

1. SFONDI HISTORIK.....	3
2. OBJEKTIVI I THIRRJES PËR PROPOZIME.....	5
3. REZULTATET E PRITSHME DHE TREGUESIT E SUGJERUAR.....	6
3.1. Mundësitë e Zhvillimit të Kapaciteteve.....	8
4. KRITERET E KUALIFIKIMIT.....	8
5. LLOJET E AKTIVITETEVE.....	9
5.1. Aktivitetet e pranueshme.....	9
5.2. Aktivitetet e papranueshme.....	10
6. PRANUESHMËRIA E SHPENZIMEVE.....	11
6.1. Shpenzimet e pranueshme.....	11
6.2. Shpenzime të papranueshme.....	11
7. KOHËZGJATJA.....	12
8. VENDNDODHJA.....	12
9. MADHËSIA E GRANTEVE.....	12
10. KRITERET E PËRZGJEDHJES DHE VLERËSIMI.....	13
10.1. Kriteret minimale.....	13
10.2. Kriteret e përzgjedhjes.....	13
11. PROCEDURA E APLIKIMIT, AFATET DHE PËRCAKTIMET KOHORE.....	14
11.1. Periudhat e parashikuara kohore.....	15
11.2. Seancat informuese.....	16

1. SFONDI HISTORIK

Barazia gjinore është një vlerë themelore e Bashkimit Evropian (BE), dhe si e tillë, duhet të strukturohet në Procesin e Anëtarësimit në BE të Ballkanit Perëndimor (BP). Garantimi që perspektiva gjinore të integrohet në të gjitha programet, përfshirë Instrumentin për Para-Anëtarësim (IPA), përfshin përpjekje të përbashkëta të institucioneve, qeverive, koordinatorëve Kombëtarë IPA (NIPAC), ministrive të linjës, zyrtarëve të BE-së, si dhe organizatave të shoqërisë civile për të drejtat e grave (OSHCG-të). Ekspertiza dhe njohuritë e OSHCG-ve janë thelbësore në mbështetjen e qeverive të BP-së në integrimin e gjinisë në programet e tyre dhe sigurimin e vëmendjes ndaj barazisë gjinore gjatë procesit të anëtarësimit në BE¹.

Ky veprim mbështetet në punën e rrjetit rajonal të avokimit të përbërë nga OSHC të të drejtave të grave dhe synon ta avancojë barazinë gjinore në BP përmes Procesit të Anëtarësimit në BE. Financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar. Partnerët rajonalë të OSHCG-së që zbatojnë këtë projekt janë: [Reactor – Research in Action](#) nga Maqedonia e Veriut, [Albanian Women Empowerment Network \(AWEN\)](#) nga Shqipëria, [Rights for all](#) nga Bosnia dhe Hercegovina (BiH), [Kosovo women's Network \(KWN\)](#) nga Kosova, [Women's Rights Centre \(ERC\)](#) nga Mali i Zi dhe [Kvinna till Kvinna Foundation](#) nga Suedi nëpërmjet zyrës së saj në Maqedoninë e Veriut.

Objektivi i përgjithshëm i këtij veprimi katërvjeçar (2020-2024) është të forcojë dhe zgjerojë bashkëpunimin rajonal ekzistues, për të forcuar demokracinë me pjesëmarrje dhe për të sjellë një proces të përafrimit ndaj BE-së me ndjeshmëri gjinore. Drejt këtij qëllimi, objektivat specifike të Veprimit përfshijnë:

- Të rriten kapacitetet e OSHCG-së që të ketë angazhim të efektshme me qeveritë, Delegacionet dhe Zyrën e BE-së (EUD/EUO), me organizatat lokale të shoqërisë civile (OSHC) dhe OSHC-të e tjera në rajon, duke i ndërgjegjësuar të gjithë aktorët e përfshirë të lidhur me dimensionet gjinore të procesit të anëtarësimit në BE;
- Të përmirësohet llogaridhënia e qeverive dhe EUD/EUO në zbatimin e angazhimeve për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave gjatë procesit të anëtarësimit në BE.

Bashkëpunimi ynë për të avancuar të drejtat e grave dhe barazinë gjinore në rajon ka ekzistuar prej më shumë se dy dekadash dhe përfshin kërkime, monitorime, angazhime qytetare, qasje ndërsektoriale për ndërtimin e koalicionit, nën-grante, ofrim shërbimesh dhe avokim të bazuar në prova që kanë për objektiv qeveritë kombëtare, mekanizmat kombëtare të barazisë gjinore, Anëtarët e Parlamenteve (kombëtare) (deputetët), EUD/EUO, Komisioni i BE-së, Shtetet Anëtare të BE-së dhe Anëtarët e Parlamentit Evropian (eurodeputetët).

¹ <https://kvinnaatillkvinna.org/publications/womens-rights-organisations-at-the-center-of-implementation-of-the-eu-gender-action-plan-3-2021-2025/>

Që nga viti 2009, anëtarët e rrjetit tonë rajonal me mbështetjen e partnerëve nga Kvinna till Kvinna kanë lobuar pranë qeverive dhe aktorëve të BE-së, i kanë bërë të mbajnë përgjegjësi për angazhimet e tyre në lidhje me të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, përfshirë pjesëmarrjen e grave dhe OSHCG-ve në procesin e Anëtarësimit dhe nxjerrjen në pah të çështjeve të të drejtave të grave në dokumentet e anëtarësimit. Prandaj, ky veprim u bazua në informacionet nga provat dhe përvoja nga puna jonë me vlerë disavjeçare si në vend ashtu edhe në rajon në lidhje me të drejtat e grave dhe barazinë gjinore.

Gjatë gjithë kësaj pune, ne kemi identifikuar disa përfundime dhe mangësi të përgjithshme:

Përfundime	Veprime për t'u ndërmarrë
<p>Ekziston një mungesë e përgjithshme e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së OSHC (G)-ve në procesin e anëtarësimit në BE dhe të drejtat e grave dhe barazia gjinore nuk janë prioritare në procesin e anëtarësimit në BE.</p> <p>Pavarësisht përmirësimeve të ndjeshme dhe presionit të vazhdueshëm nga OSHCG-të, organizatat e grave rrallëherë përfshihen në proceset që lidhen me anëtarësimin e vendeve në BE. Barazia gjinore mbetet një çështje dytësore në procesin e anëtarësimit. Procesi i para-anëtarësimit u ofron mundësinë më të mirë organizatave të grave që të mbrojnë me forcë dhe të sjellin ndryshime kur bëhet fjalë për avancimin e të drejtave të grave.</p>	<p>Ekziston nevoja për ndërveprim më të strukturuar me institucionet e BE-së, si dhe institucionet që koordinojnë procesin e para-anëtarësimit në nivelin kombëtar, në mënyrë që barazia gjinore të ketë përparësi brenda EUD/EUO nëpër vende, në qeveritë vendore, DG NEAR dhe DG JUST (përgjegjëse për integrimi gjinor). Për më tepër, në dokumentet zyrtare siç janë Raportet e Vendit dhe programimi IPA, të drejtat e grave duhet të trajtohen vazhdimisht, duke e bërë përfshirjen e organizatave të grave thelbësore në përpjekjet e avokimit si brenda vendit, ashtu edhe në Bruksel.</p>
<p>BE-ja është angazhuar për përfshirjen e çështjeve gjinore në dialogun politik dhe programimin, si dhe në rritjen e mbështetjes për mbrojtësit e të drejtave të grave dhe OSHC-të, si në Qasjen Gjithëpërfshirëse për Zbatimin e BE-së të Rezolutës 1325 ashtu edhe në Planin e BE-së të Veprimit për Gjininë III (GAP). GAP III bazohet në dokumentin e mëparshëm GAP II, i cili ka vendosur objektivin që 85% e programeve të reja të marrin një shënues gjinor 1 ose 2 të OECD-së deri në vitin 2020. Plani ndërmerr gjithashtu një angazhim të ri që të ketë të paktën një veprim për çdo vend dhe një për rajonin duke e pasur gjininë si objektivin kryesor (GM2) gjatë kohëzgjatjes së GAP III. Për më tepër, GAP III synon të trajtojë shkaqet themelore të pabarazive dhe diskriminimit nëpërmjet miratimit të një qasjeje transformuese gjinore, ndërthurjes së karakteristikave sociale në adresimin e diskriminimeve dhe qasjes së bazuar në të drejtat. Sidoqoftë, stafi i EUD/EUO, si dhe koordinatorët Kombëtarë të IPA-s (NIPAC) dhe ministritë e linjës nuk kanë gjithmonë ekspertizën e mjaftueshme</p>	<p>Organizatave që punojnë në avancimin e barazisë gjinore dhe organizatat e grave që kanë ekspertizën specifike gjinore janë thelbësore në përmirësimin e zbatimit të këtyre angazhimeve sepse monitorojnë në mënyrë aktive proceset e përafrimit me BE-në në nivelin kombëtar dhe u kërkojnë institucioneve të mbajnë përgjegjësi. Prandaj OSHC(G)-të duhet të përfshihen në këto nisma dhe aktivitete monitoruese dhe të përfaqësojnë rojet e angazhimeve për barazinë gjinore.</p>

Përfundime	Veprime për t'u ndërmarrë
<p>gjinore për t'u siguruar që të gjitha programet të përfshijnë një perspektivë gjinore. Për më tepër, ndërsa të gjitha vendet në rajonin e BP-së kanë ligje për barazinë gjinore, zbatimi i tyre është i dobët në të gjitha fushat e politikave, gjë që është e nevojshme për të siguruar integrimin gjinor.</p>	
<p>Grupet dhe organizatat për të drejtat e grave kanë ekspertizë dhe njohuri të gjerë në analizën gjinore dhe integrimin gjinor, të cilat mbështesin qeverinë në integrimin gjinor në programet e saj dhe tërheqin vëmendjen ndaj barazisë gjinore gjatë procesit të anëtarësimit në BE. Sidoqoftë, me përjashtim të disa praktikave më të mira, ekspertiza e grupeve të të drejtave të grave njihet ose përdoret pak në procesin e para-anëtarësimit në BE, kështu që perspektiva gjinore kryesisht mungon. Më gjerësisht, zbatimi i tërësisë së reformave të lidhura me anëtarësimin në BE mund të bëhet i vështirë pa mbështetjen e qytetarëve të ndryshëm në zbatimin e reformave. Për më tepër, ka prova të tkurrjes së hapësirës për organizatat e të drejtave të grave, veçanërisht për organizatat bazë dhe organizatat në nivelin vendor.</p>	<p>Ekspertiza gjinore e OSHCG-ve duhet të shfrytëzohet, pranohet dhe kompensohet në mënyrë të drejtë. Organizatat për të drejtat e grave, veçanërisht në nivelin vendor, mund të kontribuojnë në një shkallë të gjerë në sigurimin e analizave gjinore, duke siguruar kontributin gjinor në legjislaturën përkatëse, mund të integrojnë gjininë në programe në disa fusha të politikave dhe të japin një kontribut të paçmuar bazuar në përvojat e tyre dhe të grave që mbështesin.</p>

Për të trajtuar rekomandimet që rezultojnë nga puna jonë e deritanishme, partnerët e Veprimit e kanë kuptuar nevojën dhe kanë planifikuar që të bashkëpunojnë ngushtësisht me OSHC(G)-të e tjera në rajon. Në mbështetje të këtij bashkëpunimi drejt synimeve të përbashkëta, Koalicioni hap këtë Thirrje për Propozime për OSHC(G)-të e interesuara.

2. OBJEKTIVI I THIRRJES PËR PROPOZIME

Objekti i kësaj Thirrjeje për Propozime është **të mbështesë OSHC(G)-të vendore në përparimin e kapaciteteve të tyre në zonat ku ato kanë nevojë të zhvillohen më shumë, duke përdorur qasjen “të mësosh nga praktika”**. Procesi i nën-granteve do të synojë forcimin e kapaciteteve organizative, rrjetëzuese, kërkimore, monitoruese dhe avokuese të OSHC(G)-ve vendore.

Për më tepër, mbështetja financiare për OSHC(G)-të vendore nëpërmjet këtij nën-granti synon: (1) rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve për t'u angazhuar në mënyrë më efektive me qeveritë, EUD/EUO dhe OSHC-të e tjera në rajon ndërkohë që ato i bëjnë këta aktorë më të vetëdijshëm për dimensionet gjinore të procesit të anëtarësimit në BE dhe për rëndësinë dhe rolin e tyre; (2)

përmirësimin e përgjegjësive të qeverive dhe EUD/EUO në zbatimin e angazhimeve të tyre për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave gjatë këtyre proceseve.

3. REZULTATET E PRITSHME DHE TREGUESIT E SUGJERUAR

Rezultatet e pritshme përfshijnë:

- R1. Rritja dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së OSHC(G)-ve vendore në proceset e vendimmarrjes dhe në reformat e lidhura me barazinë gjinore në anëtarësimin në BE (ky aspekt përfshin marrëdhënie të përmirësuara bashkëpunimi me zyrtarë të qeverisë vendore dhe qendrore dhe aktorë të tjerë të interesuar);
- R2. Rritja dhe aplikimi i bashkëpunimit, rrjetëzimit dhe shkëmbimit të njohurive dhe praktikave më të mira (mentorimi) midis OSHC-ve në avancimin e përgjegjësive të qeverive në zbatimin e angazhimeve për barazinë gjinore gjatë procesit të anëtarësimit në BE.
- R3. Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të OSHCG-ve vendore për monitorimin, analizën gjinore, integrimin gjinor dhe avokimin e anëtarësimit në BE.

Meqenëse këto grante janë në kuadrin e veprimit të lartpërmendur dhe duhet të kontribuojnë në arritjen e këtyre rezultateve dhe trajtimin e rekomandimeve të mësipërme, këshillohet që aplikantët të konsiderojnë seriozisht përdorimin e disa prej treguesve të mëposhtëm në propozimet e tyre dhe në kornizat e tyre logjike, sipas logjikës së ndërhyrjes së këtij Veprimi më të gjerë:

Logjika	Zinxhiri i rezultateve	Treguesit
<i>Ndikimi (objektivat e përgjithshëm)</i>	<i>Bashkëpunim i zgjeruar rajonal për të forcuar demokracitë me pjesëmarrje dhe procesin e përafrimit ndaj BE-së me ndjeshmëri gjinore</i>	<p>- <u>rrjeti rajonal</u> i forcuar, duke përfshirë më shumë OSHCG (vendore dhe në bazë) dhe angazhimi i OSHC-ve të tjera si aleate, duke treguar përkushtim më të fortë, bashkëpunim dhe angazhim të përmirësuar me qeveritë dhe EUD/EUO dhe pjesëmarrje më kuptimplote në proceset e përafrimit me BE-në;</p> <p>- <u>rrjetet kombëtare</u> të forcuara të OSHCG-ve; përfshirja e lokale/në bazë dhe OSHC-ve tjera; bashkëpunim dhe angazhim i përmirësuar dhe i shtuar në procesin e anëtarësimit në BE me qeveritë kombëtare dhe EUD/EUD;</p> <p>- njohuri të shtuara mbi proceset e anëtarësimit në BE, kapacitete të përgjithshme të forcuara në drejtim të analizës gjinore dhe avokimit pranë BE-së;</p> <p>- përgjegjësi e përmirësuar e institucioneve përkatëse qeveritare dhe EUD/EUO dhe angazhime më të forta nga ana e tyre për barazinë gjinore në proceset e anëtarësimit në BE.</p>

Rezultati (et) (Objektivat (et))	<p><i>OS1: Rritja e kapaciteteve të OSHC-ve për t'u angazhuar në mënyrë efektive me qeveritë, EUD/EUO, OSHC-të e tjera dhe OSHC-të e tjerë në rajon, duke i bërë këta aktorë më të vetëdijshëm për dimensionet gjinore të procesit të anëtarësimit në BE, rëndësinë dhe rolin e tyre</i></p>	<p><i># i OSHC-ve që punojnë me barazinë gjinore dhe fusha të tjera të përfshira në zhvillimin e kapaciteteve përmes seminareve dhe qasjes "të mësosh nga praktika"</i></p> <p><i># i OSHC(G)-ve vendore/në bazë të pajisura me aftësi dhe njohuri mbi avokimin pranë BE-së, analizën gjinore, monitorimin e angazhimeve gjinore të qeverive</i></p> <p><i># i OSHC(G)-ve, përfshirë ato vendore/në bazë të përfshira në avokimin pranë BE-së me qeveritë dhe grupet përkatëse të interesit</i></p> <p><i>% e strategjisë së përbashkët rajonale të zbatuar të Avokimit</i></p>
	<p><i>OS2: Përmirësimi i përgjegjësisë së qeverive dhe EUD/ EUO në zbatimin e angazhimeve për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave gjatë procesit të anëtarësimit në BE</i></p>	<p><i># i ndryshimeve² që ndodhin si rezultat i veprimeve të avokimit dhe monitorimit të OSHC(G)-ve të ndryshme rajonale dhe kombëtare</i></p> <p><i># i institucioneve qeveritare/ose zyrtarëve, dhe EUD/EUO për çdo vend që është zotuar për të zbatuar angazhimet gjinore brenda mandatit të tyre</i></p>
Produktet	<p><i>Rezultati 1 (i lidhur me SO1 & SO2): Rrjetëzimi dhe pjesëmarrja e përmirësuar e rrjeteve ekzistuese rajonale të grave për të integruar gjininë në anëtarësimin në BE</i></p>	<p><i># i OSHC(G)-ve (përfshirë ato vendore/në bazë dhe i OSHC-ve të tjera) që marrin pjesë në veprimet dhe nismat e avokimit të rrjetit rajonal</i></p> <p><i># i OSHC(G)-ve (përfshirë ato vendore/në bazë dhe të OSHC-ve të tjera) që marrin pjesë në takimet e planifikimit të rrjeteve dhe avokimit në nivelin kombëtar dhe rajonal</i></p> <p><i># i takimeve të zhvilluara midis OSHC(G)-ve dhe grupeve të tjerë të interesuar për të planifikuar dhe ndërmarrë një avokim të përbashkët</i></p>
	<p><i>Rezultati 2 (i lidhur me SO1 & SO2): Kapacitetet e forcuara të grupeve të ndryshme vendore për të drejtat e grave mundësojnë rritjen dhe pjesëmarrjen e përmirësuar në anëtarësimin në BE</i></p>	<p><i># i OSHC(G)-ve të përfshira në procesin e mentorimit</i></p> <p><i># i OSHC(G)-ve (përfshirë ato vendore/në bazë) që marrin pjesë në seminarët për ngritjen e kapaciteteve</i></p> <p><i># i nismave të përbashkëta të avokimit në nivel rajonal dhe kombëtar lidhur me përfshirjen e OSHC(G)-ve në organet sektoriale të punës për anëtarësimin në BE</i></p> <p><i># i raporteve dhe analizave të botuara të monitorimit nga OSHC(G)-të (ato vendore/në bazë) mbi angazhimet gjinore të qeverive në kuadër të anëtarësimit në BE</i></p>

² Dallime në politika; qasje; përmbushja e angazhimeve të qeverive lidhur me gjininë në strategji, legjislacion dhe/ose politikë; përfshirja dhe pjesëmarrja thelbësore e OSHCG-ve në grupet e punës dhe proceset e pranimi në BE përmirësuan transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë në raportimin e angazhimeve gjinore.

<p><i>Rezultati 3 (i lidhur me SO2): Qeveritë, EUD/EUO mbajnë përgjegjësi për integrimin e gjinisë në procesin e anëtarësimit në BE politikisht dhe financiarisht</i></p>	<p><i># i raporteve, analizave dhe fakteve/udhëzimeve të bazuara në prova të botuara nga vendi dhe rajoni</i></p> <p><i># i çështjeve të mbuluara nga media (përfshirë mbulimin prej mediave sociale) në lidhje me angazhimet e qeverive për barazinë gjinore në kuadër të anëtarësimit në BE</i></p> <p><i># i veprimeve të përbashkëta të avokimit në nivel kombëtar dhe rajonal</i></p> <p><i># i institucioneve qeveritare/zyrtarëve dhe EUD/EUO të angazhuar në veprimet e avokimit</i></p>
---	--

3.1. Mundësitë e Zhvillimit të Kapaciteteve

Do të sigurohet një mbështetje e përshtatur për të gjithë përfituesit e granteve për të realizuar objektivat dhe rezultatet e përgjithshme. Fillimisht, secili aplikant i përzgjedhur për grante do t'i nënshtrohet një Vlerësimi të Kapacitetit Organizativ dhe Avokues (VKOA)³. Vlerësimi njëditor do të përdoret për të identifikuar pikat e forta organizative, si dhe mundësitë për zhvillimin e kapaciteteve të tyre. Bazuar në këtë vlerësim, organizatave do t'u kërkohet të zhvillojnë një Plan të thjeshtë për Zhvillimin e Kapaciteteve (PZHK) që ato mund ta realizojnë gjatë periudhës së grantit. Organizatat aplikuese inkurajohen të lënë mënjanë disa fonde në propozimet e tyre të buxhetit për këtë aktivitet dhe atyre mund t'u sigurohet edhe ekspertizë e shtuar, bazuar në nevojat e identifikuar. E gjithë mbështetja do të jepet bazuar në veprimet e përshkruara. Një VKOA vijuese do të kryhet në fund të periudhës së grantit, për të vlerësuar ndryshimet në kapacitetet organizative që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe.

Grantet e akorduara do t'i mundësojnë OSHC(G)-të të forcojnë aftësitë e tyre profesionale për të monitoruar reformat gjinore në nivelin vendor, të përgatisin raporte monitorimi, të zhvillojnë një avokim të bazuar në prova, të marrin pjesë në mënyrë më kuptimplotë në politikat vendore dhe proceset e vendimmarrjes dhe të rritin ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e zbatimit së angazhimeve që qeveritë vendore kanë marrë për politikat e barazisë gjinore. Për më tepër, nën-grantet do t'u mundësojnë OSHC(G)-ve të forcojnë kapacitetet e tyre organizative, financiare dhe të avokuese gjatë gjithë periudhës së zbatimit të aktiviteteve të nën-granteve.

4. KRITERET E KUALIFIKIMIT

Për të aplikuar, aplikanti duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

³ Kjo metodologji e respektuar, e marrë nga Indeksi i Avokimit i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe i zhvilluar më tej nga Instituti i Menaxhimit Lindje-Perëndim, përdoret në disa vende të botës për të vlerësuar kapacitetet dhe aftësitë e organizatave për të kryer një avokim efektiv.

- Të jetë i regjistruar ligjërisht dhe të veprojë në një ose më shumë nga gjashtë vendet e mëposhtme: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal i Zi, Maqedoni Veriore, Kosovë dhe Serbi;
- Të jetë jofitimprurës;
- Të jetë organizatë e shoqërisë civile;
- Të ketë qenë aktiv për më shumë se një vit;
- Të përmbushë një mision që mbështet dhe lidhet me aktivitetet e propozuara;
- Të ketë një vizion të qartë të ndryshimit që dëshiron të realizojë me iniciativën e vet, i cili do të kontribuojë në avancimin e barazisë gjinore përmes procesit të anëtarësimit në BE; dhe
- Të jetë në gjendje të vërtetojë kapacitetin dhe përvojën e vet së mëparshme në menaxhimin e projekteve me madhësi të ngjashme (në drejtim të buxhetit dhe kohëzgjatjes së kontratës së aktiviteteve të nën-granteve);
- Të mbajë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit;
- Të ketë aftësitë dhe kualifikimet profesionale të nevojshme për të përfunduar me sukses veprimin e propozuar;
- Të synojë të mbërrijë pranë personave të pafavorizuar, në nivelin bazë dhe/ose të cenueshëm (p.sh., personat që vuajnë nga diskriminimi, veçanërisht gratë, personat me aftësi të ndryshme, personat LGBTQIA+ dhe grupet e pakicave etnike, ndër të tjera); dhe
- Të ketë të paktën disa përvoja me aktivitetet e propozuara të projektit, si për shembull:
 - Nëse një organizatë dëshiron të përfshijë ndërgjegjësimin në propozimin e saj, ajo duhet të ketë të paktën një përvojë në ndërgjegjësim brenda komuniteteve të synuara;
 - Nëse një organizatë është e interesuar të mbështesë politikat dhe vendimmarrjen, përvojat përkatëse paraprake dhe ekspertiza OSE pjesëmarrja aktuale në grupe sektoriale të punës ose organe të tjera të rëndësishme/të ngjashme që merren me vendimmarrje dhe përafrimin e politikave do të konsiderohet një plus;

Sipas kësaj Thirrjeje për Propozime, çdo organizatë mund të paraqesë vetëm një kërkesë.

Përvoja në avancimin e barazisë gjinore dhe/ose të drejtave të grave inkurajohet shumë dhe konsiderohet si aset, por nuk është e detyrueshme për procesin e përzgjedhjes. Ne i inkurajojmë të gjitha organizatat vendore të dalin nga 'zona e tyre e rehatisë' dhe të sfidojnë veten me aktivitete të reja që mund të çojnë më tej integrimin gjinor në nivele të ndryshme dhe të kontribuojnë në proceset e përgjithshme të barazisë gjinore në secilin vend, duke marrë parasysh kapacitetet dhe potencialet e tyre aktuale për zbatim të suksesshëm të ideve të shtjelluara dhe aktiviteteve të planifikuara.

5. LLOJET E AKTIVITETEVE

5.1. Aktivitetet e pranueshme

Llojet e aktiviteteve të pranueshme për mbështetje financiare do të përfshijnë (por jo domosdoshmërisht të kufizohen në):

- monitorimin dhe raportimin e angazhimeve gjinore të qeverive (me fokus në autoritetet vendore) lidhur me procesin e anëtarësimit në BE, d.m.th monitorimin e zbatimit të legjislacionit dhe politikave të barazisë gjinore dhe të të drejtave të grave në nivelin vendor/komunitet, si një pjesë e rëndësishme të reformave të anëtarësimit në BE,
- avokimin pranë bartësve të çështjeve përkatëse, bazuar në gjetjet e monitorimit,
- zhvillimin e fushatave vendore të bazuara në prova dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese në lidhje me të drejtat e grave dhe avancimin e barazisë gjinore nëpërmjet Procesit të Anëtarësimit në BE në nivelin bashkiak vendor, duke përfshirë monitorimin e mediave dhe ndërgjegjësimin për përmirësimin e integritit gjinor dhe përfshirjen e përgjithshme të barabartë të grave dhe burrave në komunitet,
- fushata dhe avokim të bazuar në prova për fuqizimin e grave dhe vajzave në të gjithë larminë e tyre për të marrë pjesë në dialogun politik,
- avokim i bazuar në prova për shërbime publike të përmirësuara dhe të ndjeshme ndaj gjinisë (sektori i përkujdesit, për shembull), etj.

Lloji i personave juridikë që do të marrin mbështetje do të jenë (por jo domosdoshmërisht i kufizuar në) OSHC-të vendore dhe ato në bazë për gratë që punojnë në fushën e barazisë gjinore ose organizatat e shoqërisë civile të gatshme për të përmirësuar kuptimin e të drejtave të njeriut dhe për të çuar më tej barazinë gjinore nëpërmjet procesit të anëtarësimit në BE dhe për të kontribuar në objektivat e lartpërmendura. OSHC-të që punojnë në fusha të tjera me rëndësi për këtë veprim (përafrimi me BE, ndryshimet klimatike dhe mjedisi, dhe kështu me radhë) janë gjithashtu të mirëpritura në këtë Thirrje për Aplikime nëse janë të gatshme të mbështesin proceset e integritit gjinor në vendet e tyre përkatëse duke përmirësuar njohuritë dhe ekspertizë e tyre mbi çështjet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve mund të marrin gjithashtu mbështetje si pjesë e nismave, veçanërisht siç përcaktohet nga VKOA dhe PZHK të përfituesve të granteve (shih [më lart](#)). Aplikantët inkurajohen të lënë mënjane disa burime për këtë. Sidoqoftë, ngritja e kapaciteteve nuk duhet të jetë objektivi kryesor.

5.2. Aktivitetet e papranueshme

Llojet e veprimit që nuk janë të pranueshme përfshijnë por nuk kufizohen në:

- Veprime që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me sponsorizime individuale për pjesëmarrje në workshop-e, seminare, konferenca, kongrese dhe vizita studimore;
- Veprime që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me bursa individuale për studime ose kurse trajnimi;
- Blerja e ndërtesave ose zyra;

- Blerja e automjeteve;
- Blerja e pajisjeve (përveç nëse është e nevojshme për zbatimin me sukses të projektit);
- Veprime të lidhura me parti politike ose të natyrës politike/partiake;
- Veprime që përfshihen në aktivitetet e përgjithshme të institucioneve shtetërore kompetente ose shërbimeve të administratës shtetërore, duke përfshirë qeverinë vendore; dhe
- Veprime të lidhura me industrinë e duhanit (kodi CAEN 16); prodhimin e pijeve alkoolike të distiluara (kodi CAEN 1591) dhe armëve dhe municioneve (kodi CAEN 296).

6. PRANUESHMËRIA E SHPENZIMEVE

6.1. Shpenzimet e pranueshme

Shpenzimet e pranueshme sipas kësaj Thirrjeje janë ato:

- Të shpenzuara nga përfituesi gjatë kohëzgjatjes së veprimit DHE të lidhura me aktivitetet e planifikuara brenda kornizës së marrëveshjes së Grantit;
- Të përcaktuara në preventivin e përgjithshëm buxhetit të veprimit që shoqëron marrëveshjen e grantit;
- Të nevojshme për zbatimin e veprimit i cili është subjekt i grantit;
- Të identifikueshme, të verifikueshme, të regjistruara në regjistrat e kontabilitetit të përfituesit dhe të përcaktuara në përputhje me standardet e zbatueshme të kontabilitetit të vendit ku është vendosur/janë vendosur përfituesit dhe sipas praktikave të zakonshme të kontabilitetit të përfituesit; dhe
- Në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor dhe dhe kujdesit shoqëror në fuqi;
- Të arsyeshme, të justifikuar dhe në përputhje me parimin e menaxhimit të shëndetshëm financiar, veçanërisht në lidhje me ekonominë dhe efikasitetin.

Pagat dhe kostot operacionale, ku aplikantët shpjegojnë qartë se si një mbështetje e tillë do t'u mundësojë atyre që të avancojnë në drejtim të barazisë gjinore nëpërmjet procesit të para-anëtarësimit në BE, siç përshkruhet më sipër.

6.2. Shpenzime të papranueshme

Shpenzimet e papranueshme në këtë Thirrje janë:

- Borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit (interesi);
- Parashikime për humbje ose pasive të mundshme në të ardhmen;

- Kostot e deklaruara nga përfituesi(t) dhe të financuara nga një veprim ose program tjetër pune që kanë marrë një grant të Bashkimit Evropian (përfshirë përmes EDF) ose janë financuar tashmë nga donatorë të tjerë;
- Blerjet e tokës ose ndërtesave;
- Humbjet në këmbimin valutator;
- Kreditë për palë të treta; dhe
- Shpenzimet e pagave të personelit të nëpunësve civilë/administratës kombëtare.

7. KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e planifikuar e çdo aplikimi për projekt duhet të jetë së paku 12 muaj dhe nuk mund të kalojë 18 muaj në total.

Zbatimi i planifikuar i projektit duhet të fillojë jo më vonë se marsi 2022 dhe duhet të përfundojë jo më vonë se gushti 2023 (ky është maksimumi absolut, bazuar në afatin e përgjithshëm të veprimit, i cili mund të lejojë përgatitjen, dorëzimin dhe miratimin në kohë të raporteve përfundimtare nga ana e përfituesve të nën-granteve).

(Shënim: datat e parashikuara të fillimit të projektit duhet të jenë pas 1 dhjetorit 2021)

8. VENDNDODHJA

Aktivitetet duhet të zhvillohen në vendin ku është themeluar dhe vepron organizata, duke përfshirë Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë.

Komiteti i Rishikimit të Granteve do të synojë të shpërndajë një numër të ngjashëm të granteve për vendin partner, por, gjithashtu, të marrë parasysh kontekstin dhe mjedisin vendor të OSHC-ve, cilësinë e aplikimeve të dorëzuara dhe nivelin e ndikimit që mund të kenë në nivelin e komunitetit vendor/vendit.

Komiteti i Rishikimit të Granteve rezervon të drejtën të bëjë rregullime bazuar në propozimet e dorëzuara.

9. MADHËSIA E GRANTEVE

Shuma maksimale e përgjithshme e parashikuar për të gjitha vendet pjesëmarrësve e vënë në dispozicion për këtë Thirrje për Propozime është 450,000.00 EUR. Shuma maksimale e parashikuar për një grant individual të alokuar është 15,000.00 EUR.

Organizatat janë të mirëpritura të aplikojnë në këtë Thirrje për Propozime, duke iu referuar qartë fushës në të cilën planifikojnë të punëojnë në vendet përkatëse.

Thirrja do të rihapet vetëm nëse nuk lëvrohen fondet gjatë thirrjes së parë.

10. KRITERET E PËRZGJEDHJES DHE VLERËSIMI

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komiteti i Rishikimit të Granteve i përbërë nga gjashtë anëtarë, nga një përfaqësues i çdo organizate partnere. Për qëllimin e vlerësimit, aplikanti duhet të sigurohet që të përgatitë informacionin dhe dokumentet e kërkuara. Të gjitha aplikimet do të vlerësohen sipas hapave dhe kritereve më poshtë:

10.1. Kriteret minimale

Fillimisht të gjitha aplikimet do të kontrollohen për t'u siguruar që:

- Aplikanti plotëson [kriteret e kualifikimit](#);
- Aplikanti ka dorëzuar që të gjitha dokumentet e kërkuara në [formatin](#) e kërkuar;
- Ka respektuar afatin.

Aplikimet që nuk i plotësojnë këto kritere do të skualifikohen dhe nuk do t'i nënshtrohen shqyrtimit të mëtejshëm. Nëse plotësohen kriteret minimale të kërkuara, aplikimi do të përpunohet nga Komiteti i Rishikimit të Grantevet sipas kritereve të përzgjedhjes më poshtë.

10.2. Kriteret e përzgjedhjes

Komiteti i Rishikimit të Granteve do t'i vlerësojë me pikë propozimet bazuar në tabelën e mëposhtëm të vlerësimit. Propozimet që marrin më shumë pikë do përtë zgjidhen për të përfituar grantet në dispozicion. Aplikantët duhet të marrin të paktën 50 pikë për të përfituar fonde.

Tabela e përzgjedhjes	Pikët maksimale
I. I. Qasja teknike	60
<u>I.a.</u> I.a. Relevanca e pyetjeve dhe nevojave që mbulon aplikimi	30
I.a.1. Analiza e saktë e problemit	15
I.a.2. Përkufizimi i saktë i grupeve të synuara (të drejtpërdrejtë/të tërthortë)	10
I.a.3. Përshkrimi i saktë i menaxhimit të projektit dhe partnerëve/bashkëpunëtorëve	5
<u>I.b.</u> I.b. Cilësia e aktiviteteve të sugjeruara	15
<u>I.c.</u> I C. Aktivitete të orientuara drejt rezultateve	15
I.c.1. Kuadri i rezultateve	5
I.c.2. Afati kohor për aktivitetet	5
I.c.3 Vlerësimi dhe menaxhimi i riskut	5
II. II Kapaciteti organizativ dhe rezultatet nga përvoja e mëparshme e punës	20
II.a. Kapaciteti administrativ, financiar dhe menaxhues	10
II.a.1. Struktura e organizatës	5
II.a.2. Fusha(t) kryesore të fokusit, grupi(et) kryesore i synuar dhe zona(t) gjeografike e aktiviteteve	5
II.b. Përvojat dhe rezultatet përkatëse të mëparshme në projekte të ngjashme	10
III. III Buxheti	20
III.a. Efikasiteti i kostos	10
III.b. Menaxhimi efikas financiar	10
TOTAL	100

11. PROCEDURA E APLIKIMIT, AFATET DHE PËRCAKTIMET KOHORE

Aplikimet duhet të dorëzohen në gjuhën angleze. Aplikantët mund t'i paraqesin aplikimet e tyre edhe në një nga gjuhët lokale (në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake, malazeze ose maqedonase), por

duhet të dorëzojnë edhe një version në anglisht. Aplikimet e plota duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike në emailin e mëposhtëm: grants@reactor.org.mk, menaxhuar nga Reactor – Research in Action.

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- 1.1. Një kopje të aplikimit duke përdorur Formularin e Aplikimit, përfshirë Periudhat kohore (Formati Word, i bashkangjitur dhe i disponueshëm në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/06/1.1.-Application-Form-v1.docx>)
- 1.2. Buxheti (formati Excel, i bashkangjitur dhe i disponueshëm në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/06/1.2.-Budget-Proposal-Form-v1.xlsx>)
- 1.3. Korniza Logjike (Formati Word, i bashkangjitur dhe i disponueshëm në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/06/1.3.-Logical-Framework-v1.docx>)

Propozimet e paraqitura duhet të jenë puna origjinale dhe e vetme e organizatës aplikuese. Plagjiatura do të rezultojë në skualifikim.

Pyetjet në lidhje me Thirrjen për Propozime dhe Formularin e Aplikimit mund t'i dërgohen Reactor - Research in Action në emailin e mëposhtëm: grants@reactor.org.mk derisa [të kalojë afati për sqarime](#).

'Reactor' do të mbajë të gjitha materialet dhe dokumentet e paraqitura nga aplikantët. 'Reactor' nuk do të përdorë informacionin e paraqitur nga aplikantët për qëllime të tjera përveç rishikimit; i gjithë informacioni i paraqitur do të mbetet konfidencial, përveç nëse kërkohet nga ligji i Maqedonisë së Veriut, ose nga mbështetësit financiarë.

Pas dorëzimit të aplikimit të tyre, aplikantët do të marrin një Konfirmim të Marrjes bashkë me një numër të aplikimit.

11.1. Periudhat e parashikuara kohore

Aktiviteti	Afati
Seanca informuese	korrik 2021
Kërkesat për sqarime/informacione të mëtejshme	16 korrik 2021
Afati i fundit për dorëzimin e projektpropozimeve	30 korrik 2021

Rishikimi i kualifikimit	3 - 13 gusht 2021
Procesi i Komitetit të Rishikimit të Granteve	16 gusht – 6 shtator 2021
Kërkesat për informacione të mëtejshme nga finalistët (sipas nevojës)	9 - 24 shtator 2021
Njoftimi i marrjes së grantit	11 – 15 tetor 2021
Seanca orientuese, finalizimi dhe nënshkrimi i kontratave <i>(Shënim: datat e parashikuara të fillimit të projektit duhet të jenë pas 1 dhjetorit 2021)</i>	15 – 19 nëntor 2021

11.2. Seancat informuese

Seancat informuese të dedikuara janë një pjesë integrale e kësaj Thirrjeje për Propozime dhe do të organizohen nga partnerët e zbatimit të projektit në gjashtë (6) vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjatë seancave informuese, do të shpjegohet Thirrja për Propozime dhe do t'u jepen përgjigje pyetjeve të aplikantëve. Kalendari i seancave të planifikuara informuese është si vijon më poshtë

Prishtinë: 9 korrik 2021, 14:00 – 15:30

Zoom:

<https://us06web.zoom.us/j/85289772709?pwd=RGhxdWYwOUVwUjUzL1Y1a3Fhd2Radz09>

Meeting ID: 852 8977 2709

Passcode: 561315